

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 912/2 Prot.

Vlorë më, 12.03 2025

VENDIM
Nr. 23, datë 11.03.2025

PËR
MIRATIMIN E NUMRIT TË PERSONELIT NË TË GJITHA NIVELET NË
UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORË

Në mbështetje të nenit 49, pika 1, gërma ç, të Ligjit nr.80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kerkimin shkencor, në institucionet arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*" nenit 25 pika 1, gërma ç të Statutit të UV-së, si dhe referuar propozimit të Rektorit të UV-së, ardhur me shkresë Nr884, prot. datë, 10.03.2025, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 11.03.2025,

VEREN SE:

Me vendimin nr.14 datë 24.02.2025 të Senatit Akademik "Për disa ndryshime në strukturën organizative, numerike dhe Organigramën e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, është miratuar Struktura organizative, numerike dhe Organigrama e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë në nivel ndihmësakademik dhe administrativ. Po ashtu në këtë vendim, i është propozuar Bordit të Administrimit numri i personelit në të gjitha nivelet. BA vëren se struktura është organizuar në tri Drejtori. Drejtoria e Shërbimeve Ndihmës-Akademike, Drejtoria e Kërkim-Zhvillimit dhe Marrëdhënieve me të Tretët dhe Drejtoria e Shërbimeve Administrative. Drejtoritë janë të organizuar në sektorë, ku çdo sektor ka një përgjegjës. Gjithashtu në dispozitiv është përcaktuar se struktura organizative, numerike dhe organigrama do të jetë pjesë e Statutit të ri të UV-së, sipas nenit 33 të Ligjit nr.80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kerkimin shkencor, në institucionet arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*" Bordi i Administrimit konstatoi se numri i propozuar nga ana e Senatit Akademik nuk ka ndryshuar. Në vendim përcaktohet qartë se strukturat administrative në nivel institucioni dhe në nivel njësie kryesore janë në varësi të Administratorit, strukturat akademike, ndihmësakademike me karakter mësimor dhe ndihmësakademike me karakter administrativ janë në varësi të rektorit, ndërsa sektori i auditit është në varësi të Bordit të Administrimit. Kjo hierarki paraqitet edhe në organigramën e cila ndodhet bashkëlidhur këtij vendimi. Organigrama do të jetë gjithashtu pjesë e Statutit të ri të UV-së, sipas nenit 33 të Ligjit nr.80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kerkimin shkencor, në institucionet arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*" si dhe të Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit Nr. 27, datë 29.12.2027, "Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë". Në këto kushte Bordi i Administrimit, në mbledhjen e datës 11.03.2025,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT

VENDOSI:

1. Të miratojë numrin e personelit në të gjitha nivelet në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, me kusht që rekrutimet e punësimit për personelin e shtuar të bëhen me vendimmarrje paraprake nga ana e Bordit të Administrimit sipas gjendjes financiare.
2. Të miratojë numrin e personelit në të gjitha nivelet në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, gjithsej 359 (treqind e pesëdhjetë e nëntë) të shpërndarë si më poshtë:
 - a. Numri i përgjithëm i personelit akademik me kohë të plotë:
236 (dyqind e tridhjetë e gjashtë)
 - b. Numri i përgjithëm i personelit ndihmësakademik dhe administrativ:
123 (njëqind e njëzetë e tre)

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Sotir NIKOLLA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
REKTORI

Nr. 834 Prot.

Vlorë më, 12.03.2025

Lënda: Përcjellje e propozimit për miratimin e Strukturs numerike në të gjitha nivelet në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë

**BORDIT TË ADMINISTRIMIT TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORË,
Z. SOTIR NIKOLLA**

KËTU

Në mbështetje të nenit 38, pika 1, shkronja ç, të ligjit Nr.80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", nenit 19, pika 1, shkronja ç, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Udhëzimit nr.27 të MAS datë 29.12.2017, "Strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të Ardimit të Lartë", referuar sugjerimeve të MAS me shkresë nr. 929/1, prot, datë, 17.02.2025 si dhe Vendimit Nr.14, të SA, datë, 24.02.2025 "*Për disa ndryshime në strukturën organizative, numerike dhe Organigramën e UV-së*", ku janë pasqyruar të gjitha sugjerimet e kërkuara po Ju përcjellim për miratim përfundimtar në BA, strukturën numerike të UV bashkëngjitur këtij dokumenti.

1. Struktura numerike jo-akademike e Universitetit 'Ismail Qemali' në të gjitha nivelet ndryshon si më poshtë:
 - a. Shtohen 3 pozicione Drejtor drejtorie.
 - b. Sektori i Kurrikulave dhe Statistikës pakëson përbërjen në 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë (nga 4 specialistë që kishte më parë).
 - c. Numri i laborantëve të Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore pakësohet në 6 laborantë (nga 7 që kishte më parë).Struktura numerike e ndryshuar paraqitet bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Numri i personelit me angazhim me kohë të plotë në të gjitha nivelet në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, mbetet i pandryshuar: 359 (treqind e pesëdhjetë e nëntë), sipas Vendimit 97, datë 17.12.2024, dhe Vendimit 01, datë 17.01.2025 të SA, i shpërndarë si më poshtë:
 - a. Numri i përgjithshëm i personelit akademik me kohë të plotë nuk ndryshon: 236 (dyqind e tridhjetë e gjashtë)
 - b. Numri i përgjithshëm i personelit ndihmës-akademik dhe administrativ nuk ndryshon: 123 (njëqind e njëzetë e tre).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
REKTORI

Bashkëlidhur keni relacionin e zyrës Juridike dhe Strukturën numerike propozuar nga UV sipas Vendimit Nr.14 të Senatit Akademik datë, 24.02.2025.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin!


REKTOR

Prof. Dr. Aurela Saliaj



Adresa /Address: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288

Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
REKTORI**

**STRUKTURA ORGANIZATIVE NUMERIKE
NDIHMËS-AKADEMIKE DHE ADMINISTRATIVE
E UNIVERSITETIT 'ISMAIL QEMALI'**

Nivel Institucioni

Struktura Akademike

1. Rektori
2. Zv.Rektori Akademik
3. Zv.Rektori për Marrdhëniet me Jashtë dhe Kërkimin Shkencor

Struktura ndihmës akademike me karakter administrativ

Asistenti i Rektorit	1
Drejtoria e Shërbimeve ndihmës-akademike	
Drejtor i Shërbimeve ndihmës-akademike	1
1. Sektori i kurrikulave dhe statistikave	
specialist i komunikimit me QSHA dhe MASR (përgjegjës sektori)	1
specialist i kurrikulës dhe statistikës për FSH dhe FE	1
specialist i kurrikulës dhe statistikës për FSHTN dhe FSHH	1
2. Sektori i sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe akreditimit	
specialist akreditimi dhe raportimi me ASCAL (përgjegjës sektori)	1
specialist raportimi	1
specialist sondazhesh	1
3. Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Arkiv-Protokollit	
specialist i marrdhënieve SA, BA, Rektorat, Komisioneve të Përhershme dhe koordinator i Asamblesë së Personelit akademik. (përgjegjës sektori)	1
specialist protokolli	1
specialist arkive	1
specialist i burimeve njerëzore	1
4. Sektori juridik	
specialist për hartim dhe interpretim dokumentacioni ligjor (përgjegjës sektori)	1
specialist jurist për marrveshjet institucionale	1
specialist jurist	1

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288

Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
REKTORI

specialist programimi (përgjegjës sektori)	1
specialist serverash dhe digitalizimi	1
specialist rrjetesh kompiuterike dhe audio-video	1
6. Sektori i bibliotekës dhe botimeve	
specialist i laboratorit mediatik UV (përgjegjës sektori)	1
specialist bibliotekës digitale	1
specialist botimesh	1
Drejtorja e Kërkim-Zhvillimit dhe Marrdhënieve me të tretët	
Drejtor i Kërkim-Zhvillimit dhe Marrdhënieve me të tretët	1
1. Sektori i kërkimit shkencor dhe projekteve	
specialist projektsh (përgjegjës sektori)	1
specialist për kërkimin shkencor dhe doktoratat	1
specialist për organizimin e aktiviteteve shkencore	1
2. Sektori i marrdhënieve me jashtë	
specialist komunikimi me institucionet – zëdhënës Rektorati (përgjegjës sektori)	1
specialist për mobilitetet Erasmus+ dhe koordinimin e aktiviteteve ndër-institucionale	1
specialist informacioni	1
3. Sektori i promovimit dhe marrdhënieve me publikun	
administrator i rrjeteve sociale UV (përgjegjës sektori)	1
specialist promocioni (pregatitje materialesh promocionale)	1
specialist marketingu	1
4. Sektori i karrierës, shërbimit të studentëve dhe alumni	
specialist i karrierës dhe alumnëve (përgjegjës sektori)	1
specialist i shërbimit të studentëve	1
specialist për aktivitetet socio-kulturore	1
5. Qendra e Zhvillimit Rajonal	
drejtues i qendrës (personel akademik)	
specialist për koordinimin e aktiviteteve institucionale	1

Struktura Administrative

1. Bordi i Administrimit	
2. Administratori	1
Sektori i Auditimit të brendshëm	
përgjegjës sektori	1

Adresa / Address: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288

Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
REKTORI

specialist auditit – profili jurist	1
specialist auditit – profili ekonomist	1
Drejtorja e Shërbimeve Administrative	
Drejtor i Shërbimeve Administrative	1
1. Sektori ekonomik	
përgjegjës sektori	1
specialist ekonomie	2
magaznier	1
2. Sektori i prokurimeve dhe investimeve	
përgjegjës sektori	1
specialist prokurimi – profili inxhinier	1
specialist prokurimi – profili ekonomist	1
3. Sektori i shërbimeve	
përgjegjës sektori	1
specialist shërbimesh	2
shofer	2
punonjës pastrimi	1

Nivel Njësish Kryesore

FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE

Struktura Akademike

Struktura ndihmës akademike me karakter administrativ

1. Sekretaria mësimore e FSHTN	
Kryesekretare	1
Sekretare mësimore	4
2. Asistenti i Dekanit / Specialist i Arkiv-Protokollit	1
3. Dega e Shërbimeve Ndihmës/akademike	
a. Specialist i Zyrës së Studentëve	1
b. Specialist për Bibliotekën	1
c. Specialist IT	1

Struktura ndihmës akademike me karakter akademik

Specialist në QKSH	1
Laborant në njësitë bazë	6

Struktura Administrative

Dega e Shërbimeve Administrative

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288

Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
REKTORI

a. Specialist finance	1
b. Shërbime:	
mirëmbajtës (hidraulik, elektrikist)	1
punonjës pastrimi.	4

FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE

Struktura Akademike

Struktura ndihmës akademike me karakter administrativ

1. Sekretaria mësimore e FSHH	
Kryesekretare	1
Sekretare mësimore	4
2. Asistenti i Dekanit / Specialist i Arkiv-Protokollit	1
3. Dega e Shërbimeve Ndihmës/akademike	
a. Specialist i Zyrës së Studentëve	1
b. Specialist për Bibliotekën	1
c. Specialist IT	1

Struktura ndihmës akademike me karakter akademik

Specialist në QKSH	1
Laborant në Dep. e Gjuhëve të Huaja	1

Struktura Administrative

Dega e Shërbimeve Administrative	
a. Specialist finance	1
b. Shërbime:	
mirëmbajtës (hidraulik, elektrikist)	1
punonjës pastrimi.	3

FAKULTETI EKONOMIK

Struktura Akademike

Struktura ndihmës akademike me karakter administrativ

1. Sekretaria mësimore e FE	
Kryesekretare	1
Sekretare mësimore	3
2. Asistenti i Dekanit / Specialist i Arkiv-Protokollit	1
3. Dega e Shërbimeve Ndihmës/akademike	
a. Specialist i Zyrës së Studentëve	1
b. Specialist për Bibliotekën	1
c. Specialist IT	1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
REKTORI

Struktura ndihmës akademike me karakter akademik

Specialist në QKSH	1
Laborant QKSH	1
Laborant i Departamentit të Biznesit	1

Struktura Administrative

Dega e Shërbimeve Administrative

a. Specialist finance	1
b. Shërbime:	
mirëmbajtës (hidraulik, elektrikist)	1
punonjës pastrimi.	3

FAKULTETI SHËNDETIT

Struktura Akademike

Struktura ndihmës akademike me karakter administrativ

1. Sekretaria mësimore e FSH	
Kryesekretare	1
Sekretare mësimore	2
2. Asistenti i Dekanit / Specialist i Arkiv-Protokollit	1
3. Dega e Shërbimeve Ndihmës/akademike	
a. Specialist i Zyrës së Studentëve	1
b. Specialist për Bibliotekën	1
c. Specialist IT	1

Struktura ndihmës akademike me karakter akademik

Specialist në QKSH	1
Laborant në Dep. e Infermierisë	2
Laborant në Dep. e Kujdesit Shëndetësor	1
Laborant për laboratorin klinik	1



Struktura Administrative

Dega e Shërbimeve Administrative

a. Specialist finance	1
b. Shërbime:	
mirëmbajtës (hidraulik, elektrikist)	1
punonjës pastrimi.	2

TOTAL

123



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI JURIDIK

Nr. 245 Prot.

Vlorë, më 14 / 2 /2025

RELACION


"Në lidhje me strukturën organizative, numrin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ në Universitetin "Ismael Qemali", Vlorë, si dhe organigramën e saj"

**REKTORES SË UNIVERSITETIT
"ISMAIL QEMALI" VLORE
PROF.DR. AURELA SALIAJ**

Ky relacion ka për qëllim argumentimin në mënyrë të detajuar të shkaqeve që çojnë në riorganizimin dhe miratimin e strukturës së Re organizative në Universitetin "Ismael Qemali", të Vlorës, numrit të përgjithshëm të personelit të parashikuar në strukturën e Re, përcaktimeve ligjore, udhëzimeve të MAS si edhe mënyrës së re të organizimit në nivel drejtorie, sektori, zyra.

Miratimi i strukturës së Re organizative në UV, është një proces kyç që ka për qëllim përcaktimin e hierarkisë dhe ndarjes së përgjegjësiave dhe detyrave brenda saj.

Bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 3 "*Liria akademike dhe autonomia e institucioneve të arsimit të lartë*" në Udhëzimin Nr. 27, datë 29.12.2017 të MASR, "*Për strukturën e brendëshme akademike dhe administrative në institucionet e arsimit të lartë*", Vendimit të Senatit Akademik Nr. 89 datë 21.11.2024 për "*Miratimin e strukturës organizative të personelit ndihmësakademik dhe administrativ*" të Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë, Vendimit Nr. 97, datë 17.12.2024 për "*Miratimin e strukturës numerike të përgjithshme dhe organigramës*" të Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë, Vendimit të Bordit të Administrativ Nr. 2, datë 09.01.2025 për "*Për Miratimin kategorive të pagave të*"



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SEKTORI JURIDIK

personelit dihmësakademik me karakter mësimor, ndihmësakademik me karakter administrativ dhe personelit administrativ të Universitetit Ismail Qemali" Vlorë, si dhe referuar shkresës së MAS me Nr.929/1 Prot. datë 17/02/2025 lënda " Kthim përgjigje", për përmbushjen e objektivave dhe synimeve që Universiteti ka miratuar në strategjinë e tij, si dhe për një organizim sa më efektiv të burimeve njerëzore, në përmbushje të detyrave funksionale, po Ju përcjellim bashkëlidhur kësaj shkrese argumentat për të riorganizuar strukturën organizative egzistuese të miratuar me Vendim Senati Nr. 97, datë 17.12.2024 "Miratimin e strukturës numerike të përgjithshme dhe organigramës" të Universitetit "Ismail Qemali" si më poshtë:

Në zbatim të Udhëzimit të MASR Nr. 27 "Për strukturën e brendëshme akademike dhe administrative në institucionet e asimit të lartë", në pikën 13 është përcaktuar se:

Pika 13 e Udhëzimit Nr. 27, datë 29.12.2017


"Në nivel institucional, strukturat me personel ndihmes akademik me karakter administrativ dhe personel administrativ organizohen në drejtori, sektorë dhe zyra, ku secila drejtori nuk mund të ketë me pak se dy sektorë apo zyra, secili sektor apo zyrë nuk mund të ketë më pak se tre specialist"

Referuar shkresës së MAS si dhe në organizimin e punëve pas implementimit të strukturës së Re gjatë të cilës janë vënë re se mungesa e drejtorive ka sjell një moskoordinim si dhe mos realizim të objektivave, kërkohet një riorganizim i strukturës në nivelin e saj më të lartë me drejtori. Organizimi i strukturës së Re në nivel drejtorie, sektor ose zyra është konform pikës 13 të Udhëzimit Nr. 27, datë 29.12.2017 të MASR dhe çmohet se ekzistenca e drejtorive është e rëndësishme në përcaktimin e politikave organizative të sektorëve të veçantë që përmbledhen në këto drejtori si dhe objektivave që duhet të arrijnë sektorët.

Organizimi me nivel drejtorie është i rëndësishëm dhe roli i drejtorit përfshinë:


➤ Planifikimin dhe organizimin:

Drejtori duhet të sigurojë që objektivat e drejtorisë të arrihen dhe të zhvillohen strategji afatgjata për të mbështetur zhvillimin e institucionit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SEKTORI JURIDIK

- Menaxhimi i burimeve njerëzore:
Drejtori menaxhon stafin dhe ndihmon zhvillimin profesional të punonjësve.
- Kontrolli dhe monitorimi:
Drejtori është përgjegjës për mbikëqyrjen e proceseve të punës dhe për sigurinë që objektivat e drejtorisë të realizohen në mënyrë efikase dhe të suksesshme.
- Sigurimi i zbatimit të ligjit dhe rregulloreve:
Drejtori siguron që puna e drejtorisë bëhet në përputhje me ligjet dhe politikat përkatëse.
- Menaxhimi i stafit:
Drejtori është përgjegjës për udhëheqjen dhe koordinimin e ekipit të punës, përfshirë rekrutimin, trajnimin dhe vlerësimin e punonjësve.
- Vendimmarrja strategjike:
Përgjegjësia kryesore është të marr vendime strategjike që ndikojnë në performancën dhe zhvillimin e sektorëve nën drejtimin e tij. Ai merr vendime të rëndësishme lidhur me politikën, strategjinë dhe zhvillimin e drejtorisë, duke siguruar që objektivat dhe prioritetet të realizohen.
- Zhvillimi i politikave dhe procedurave:
Drejtori krijon dhe implementon politika dhe procedura që sigurojnë funksionimin efikas dhe të qëndrueshëm të drejtorisë.
- Përbushja e objektivave dhe raportimi:
Ai është përgjegjës për arritjen e objektivave të sektorëve dhe raporton për ecurinë e tyre.
- Krijimi i një ambienti të mirë pune:
Përveç aspekteve menaxheriale, drejtori është i angazhuar edhe në krijimin e një ambienti pozitiv për punonjësit, duke ndihmuar në motivimin dhe zhvillimin e tyre.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI JURIDIK

Në përmbledhje, drejtori ka përgjegjësi të gjerë dhe kërkon aftësi të shumta, nga menaxhimi i burimeve njerëzore deri te krijimi i një drejtimi strategjik për suksesin e drejtorisë. Organizimi me drejtori nënkupton menaxhimin sa më të mirë të strukturës së re. Ky organizim përfshin planifikimin, delegimin, ndarjen e përgjegjësisë, vendimarrjen dhe komunikimin mes niveleve të ndryshme të menaxhimit.

Riorganizimi me drejtori nuk e ndryshon numrin e personelit me angazhim me kohë të plotë në të gjitha nivelet në Universitetin "Ismael Qemali" Vlorë, ky numër mbetet i pandryshuar, 359 (treqind e pesëdhjetë e nëntë), sipas Vendimit Nr. 97, datë 17/12/2024 i Senatit Akademik, i cili është shpërndarë si më poshtë:

- a. Numri i përgjithëm i personelit akademik me kohë të plotë nuk ndryshon 236 (dyqind e tridhjetë e gjashtë)
- b. Numri i përgjithëm i personelit ndihmës-akademik dhe administrativ nuk ndryshon 123 (njëqind e njëzetë e tre).

Struktura organizative do të jetë pjesë e Statutit të UV-së sipas sipas nenit 33 të Ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, në institucionet arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin!

PËRGJEGJËSE SEKTORIT JURIDIK

JULITA SHABANI